



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-032
Prishtinë, më 13 shtator 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 13 SHTATOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 shtator 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 shtator 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 shtator 2011, u miratua pa vërejtje.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca, pati vërejtje në Transkript, në faqen 5, që është përmirësuar sipas vërejtjes së tij.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të enjten dhe të premten, më 22 dhe 23 shtator 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Trustit të Kursimeve Pensinale të Kosovës, për vitin 2010,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e drejtorit të

- Agjencisë kundër Korrupsionit,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
 14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
 15. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave.

Po ashtu, Kryesia vendosi që edhe njëherë të mblidhet të hënën, më 19 shator 2011, me kryetarët e grupeve parlamentare, për ta konfirmuar rendin e ditës dhe për ta plotësuar eventualisht me shqyrtimin e dytë të ndonjë projektligji, që përgatitet ndërkohë.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Njoftimi i Grupit Parlamentar “6+” për ndërrimin e kryetarit të këtij grupi parlamentar me rrotacion

Me kërkesë të propozuesit, kjo pikë u hoq nga rendit i ditës.

3.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

4. Të ndryshme:

Nënkryetari **Glauk Konjufca**, ngriti shqetësimin lidhur me Projektligjin për Qendrën historike të Prizrenit, të cilin nuk e kishte miratuar Kuvendi, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2011. Ai tha se Qeveria e Kosovës ka riproceduar të njëjtin projektligj, pa asnjë ndryshim.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Projektligjin për Qendrën historike të Prizrenit, konkludoi që i njëjti të mos radhitet në mbledhje plenare, derisa të bëhen konsultimet e nevojshme.

Nënkryetari **Sabri Hamiti**, ngriti çështjen e orarit të mbledhjeve të Kryesisë. Ai propozoi që koha ndërmjet mbajtjes së mbledhjes së Kryesisë dhe të seancës plenare të jetë më e gjatë se dy ditë. Ai këtë e arsyetoi me vërejtjet e grupeve parlamentare se nuk po kanë kohë të mjaftueshme për t'i analizuar materialet për pikat e propozuara për seancë plenare.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen që ngriti nënkryetari Hamiti, vendosi që mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit të mbahen të hënën, në vend të ditës së martë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.